

**Hapet thirrja për aplikime për bursa trajnimi në Universitetin Middle East Technical University (METU), në Ankara, Turqi, për stafin me kohë të plotë të zyrave të marrëdhënies me jashtë, stafin me kohë të plotë të zyrave të marrëdhënies me studentët, stafin me kohë të plotë të zyrave të administrimit të projekteve dhe kërkimit shkencor të Universitetit të Tiranës.**

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin me kohë të plotë të zyrave të marrëdhënies me jashtë, stafin me kohë të plotë të zyrave të marrëdhënies me studentët, stafin me kohë të plotë të zyrave të administrimit të projekteve dhe kërkimit shkencor për trajnim të Universitetit të Tiranës.

### **Llojet e mobilitetit:**

-Shkëmbimin e stafit për trajnim;

<https://www.metu.edu.tr/>

### **Kohëzgjatja:**

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit (datat 17 – 21 Qershor 2019);

### **Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin ditor për stafin (140 EUR në ditë);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim:**

- CV (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;
- Plani i mobilitetit për trajnim\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

[http://www.unitir.edu.al/images/Training\\_mobility\\_plan.docx](http://www.unitir.edu.al/images/Training_mobility_plan.docx)

\*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

**Afati për aplikim:** 18 Prill 2019

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!